



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT - SECRETARAIT

**KONKLUZIONET E PUNËTORIVE REGJIONALE MBI IMPLEMENTIMIN E KODIT TË
PROCEDURËS PENALE.**

**Raporti i Konsoliduar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
Gjyqtar Referues Skender Çoçaj, Gjykata Themelore Prizren
29 Nëntor 2014**

A. Hyrja

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i përkrahur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, gjatë këtij viti, duke filluar nga muaji shtator deri në muajin nëntor realizoi gjithsej katërmëdhjetë (14) punëtori, nga dy për çdo gjykatë themelore të Kosovës, në të cilat ishin ftuar pjesëmarrës – gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë nga rajonet gjegjëse për të diskutuar zbatimin e deritanishëm të Kodit të Procedurës Penale
2. Në çdo rajon u zhvilluan debate mjaft konstruktive si rezultat i të cilave u sollën një sërë konkluzionesh dhe rekomandimesh konkrete, të cilat do t'i shërbejnë Këshillit Gjyqësor në shqyrtimin e ndikimit të reformave të sistemit të drejtësisë si dhe përputhshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare
3. Këto punëtori u kryesuan nga anëtarët e KGJK-së dhe Departamenti Ligjor i KGJK-së.
4. Gjate punëtorive në të gjitha rajonet u diskutuan shumë tema që janë të rëndësishme për këtë pikë të agjendës sot. Të gjitha këto janë të përmbledhura nga gjyqtarët raportues të caktuar për çdo rajon të gjykatës themelore në formë të konkluzioneve dhe rekomandimeve të veçanta, që i keni të printuara bashkë me materialet tjera që i keni marrë për këtë Konferencë. Pas përfundimit të të gjitha punëtorive, shtatë gjyqtarët raportues patën një takim të përbashkët në të cilin u vendos që, meqë shumë nga konkluzionet dhe rekomandimet nga rajonet e ndryshme ishin të ngjashme, të bëhet një përmbledhje e konkluzioneve dhe rekomandimeve të cilat do të prezantohen vetëm nga një gjyqtar raportues.

5. Kolegët e mi – gjyqtarët raportues të çdo rajoni por edhe ju kolegë të nderuar do të keni mundësi të intervenoni me diskutime më të detajuara në lidhje me këto tema. Më lejoni si për fillim të prezantoj një përmbledhje të disa nga diskutimet më të rëndësishme që u bënë në këto punëtori, të ndara në disa tema specifike:

B. Shqyrtimi fillestar dhe i dytë dhe mundësitë e shtuara të palëve për të mbledhur prova

6. Në shumë punëtori erdhëm deri te përfundimi se nuk ekziston një praktikë e vetme në mes të gjyqtarëve rreth shqyrtimit fillestar dhe atij të dytë (përkundër qarkores juridike të Gjykatës Supreme). Në rastet kur nuk paraqiten kundërshtime ndaj dëshmimeve të cekura në aktakuzë, ose ndonjë kërkesë për hedhjen e aktakuzës, disa gjyqtarë e caktojnë shqyrtimin e dytë ndërsa disa të tjerë e caktojnë shqyrtimin kryesor. Edhe pse Kodi i ri u siguron palëve në procedurë më shumë mundësi për prezantimin e provave të tyre, kjo zbatohet me vështirësi në praktikë. Janë gjykatat përsëri ato që shpesh e bëjnë mbledhjen e provave. Disa nga pjesëmarrësit u pajtuan që shqyrtimi fillestar dhe i dytë ndonjëherë janë vetëm humbje kohe ngase të gjitha aktivitetet procedurale mund të përqendrohen dhe ndërmerren në kuadër të një shqyrtimi të vetëm përgatitor, - në veçanti kur janë në pyetje veprat e lehta penale dhe në rastet kur nuk ka propozime apo kundërshtime nga i pandehuri dhe mbrojtja.

C. Roli i palës së dëmtuar

7. Kodi i Procedurës Penale përcakton që i dëmtuari duhet të jetë i pranishëm gjatë shqyrtimit kryesor, mirëpo, ka raste kur ai nuk kanë interesim të marrë pjesë në procedurë dhe për këtë arsye shqyrtimet duhen shtyrë. Ka mospërputhshmëri në Kod në lidhje me praninë e palës së dëmtuar gjatë shqyrtimit fillestar: përderisa prania e të dëmtuarit gjatë shqyrtimit fillestar nuk është e paraparë (neni 245), në rast të pranimit të fajësisë në këtë shqyrtim mund të kërkohet edhe mendimi i palës së dëmtuar (neni 248(2)). Prania e palës së dëmtuar nuk është e obliguar në seancë fillestare në bazë të nenit 245(1). Por, në qoftë se pranimi i fajësisë është deklaruar në këtë seancë, atëherë pikëpamjet e palës së dëmtuar duhet të merren parasysh. Avokatët pothuajse njëzëri erdhën në përfundim se braktisja e mundësisë së paditësit subsidiar në rastet kur prokuroria heq dorë nga ndjekja paraqet pengesë serioze për palën e dëmtuar.

D. Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

8. Një numër i caktuar i rasteve përfundojnë me pranim të fajësisë, ndonëse, shumica prej tyre arrihen pas ngritjes së aktakuzës. Është e vështirë të arrihet marrëveshje para ngritjes së aktakuzës pasi që prokuroria nuk mund të propozojë dënim më të ulët se minimumi i paraparë me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ndërsa kur rasti i të pandehurit arrin në shqyrtim gjyqësor, gjykata e ka mundësinë – të cilën edhe e përdorë shpesh – që ta ulë dënimin nën minimumin e lejuar duke i zbatuar “rrethanat posaçërisht lehtësuese” (neni 75 i Kodit Penal). Çështja e pranimi të fajësisë është problematike kur aktakuza përmban më shumë pika të akuzës, dhe i pandehuri nuk ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat, por vetëm një ose disa prej tyre. (Neni 248 i Kodit). Praktika gjyqësore në situata të tilla nuk është e unifikuar për shkak të mungesës së udhëzimit. Ngjashëm me këtë problem është çështja e rasteve që përfshijnë dy ose më shumë të pandehur. Nëse një nga të pandehurit pranon fajin dhe tjetri jo, a duhet gjykata të merr menjëherë një aktgjykim për atë që u deklarua fajtor apo të presë derisa rasti është përfunduar me të pandehurin tjetër dhe të nxjerrë një aktgjykim për të dy. Ekziston rreziku se i pandehuri i cili u deklarua fajtor (ka pranuar fajësinë) mund të revokojë atë në çdo fazë gjatë vazhdimi të gjykimit kryesor kundër të pandehurit tjetër..

E. Marrja në pyetje e drejtpërdrejtë, e tërthortë dhe rimarrja në pyetje

9. Gjatë të gjitha punëtorive, nëpër të gjitha gjykatat është konstatuar se këto teknika të reja të marrjes në pyetje shpeshherë nuk zbatohen në mënyrë të duhur.

F. Paraburgimi

10. Shumica e pjesëmarrësve konstatuan që ka raste kur kërkesat e prokurorit për caktim ose vazhdim të paraburgimit nuk paraqiten në kohë ose nuk janë të arsyetuara mirë. Duhet të ketë mbikëqyrje më efikase të masës së paraburgimit nga ana e gjykatave. Afatet e parapara në Kod për sa i përket ankesave kundër vendimeve për paraburgim shpesh nuk respektohen. Përmirësimi i kësaj gjendje është nevojë urgjente.

G. Si dhe temat specifike si për shembull

- Gjykimet nuk incizohen me mjete audio/video, në kuptim të nenit 315 të KPP-së.
- Departamenti për krime të rënda është i ngarkuar me vepra penale të cilat mund të kalojnë në departament të përgjithshëm.

- Disa dispozita të KPP-së janë në kundërshtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Për shembull, neni 53(5) i KPP-së parasheh që personat nën moshën 18 vjet mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës, ndërsa Kodi për të Mitur kërkon detyrimisht mbrojtës. Gjithashtu të sqarohet çështja se cili kod duhet zbatuar në rastet në të cilat janë të involvuar madhorët e rinj.
- Ka një perceptim të përgjithshëm se ka mangësi jo vetëm me zbatimin e Kodit, por edhe mospërputhje të shumë dispozitave të të njëjtit, gjë që kërkon një qasje më gjithëpërfshirëse për amendamentimin e tij.
- Pa pretenduar të jetë një listë gjithëpërfshirëse, më lejoni të bëj një përmbledhje të disa nga rekomandimeve më të përmendura gjatë këtyre punëtorive:
- Të dyja palët, si prokuroria ashtu edhe mbrojtja duhet të marrin një rol më aktiv gjatë propozimit të dëshmimeve në fazat më të hershme të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa gjyqtari i procedurës paraprake duhet të ruajë rolin dominues në përgatitjen e rastit dhe të bëjë vlerësimin e propozimeve të palëve me kujdes;
- Sa i përket negociimit të marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë, avokatët dhe prokurorët duhet të punojnë më tepër rreth këtij instituti të ri, në benefitin e tyre të dyanshëm. Të gjitha rastet, ku e lejon ligji, duhet fillimisht të nisin duke i propozuar marrëveshje të pandehurve. Ndërsa gjykatat duhet t'i analizojnë dhe rishikojnë politikat e tyre ndëshkimore më qëllim që të ndikojnë në rritjen e rasteve që përfundojnë me negociimin e marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë;
- Pala e dëmtuar duhet të jetë prezentë në procedurë që nga seanca fillestare;
- Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët duhet të aftësohen edhe më tej mbi teknikat e marrjes në pyetje e në veçanti të atyre mbi marrjen e tërthortë në pyetje;
- Para se të propozohet paraburgimi, të shqyrtohet nëse është e mjaftueshme të shqiptohet ndonjë nga masat alternative. Prokurorët duhet t'i paraqesin propozimet për caktim të paraburgimit me kohë si dhe t'i arsyetojnë ato. Gjykatat duhet t'i hedhin poshtë propozimet e paafatshme ndërsa t'i refuzojnë propozimet jo të arsyetuara mirë. Është përgjegjësia përfundimtare e gjyqtarit për të siguruar që arsyet e paraburgimit janë të mjaftueshme dhe të shtjelluara deri në imtësi;
- Të gjitha shqyrtimet gjyqësore duhet të incizohen përmes mjeteve audio dhe video në mënyrë që të jenë në pajtim të plotë me KPP-në

Implementimi i Kodit të të Procedurës Penale: Report i Konsoliduar

- Kodi i Procedurës Penale duhet të harmonizohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.
- Rishikimi i neneve të veçanta të Kodit, e sidomos ato në lidhje me: 1) rolin e palës së dëmtuar në procedurë penale; 2) ato mbi domosdoshmërinë e shqyrtimit të dytë në të gjitha rastet penale; 3) Rishikimi i nenit 22 për sa i përket veprave penale të ndara në departamente. Disa vepra penale si për shembull armëmbajtja pa leje duhet të kalojë nga Departamenti për krime të rënda në Departamentin e përgjithshëm. Përderisa vepra penale shmangie nga tatimi për vlera të larta duhet të kalojnë nga Departamenti i përgjithshëm në Departamentin për krime të rënda. Dhe për fund, rekomandimi që të amendamentohet Kodi për të gjitha ato çështje dhe dispozita që nuk u përmendën në këtë përmbledhje, por që u identifikuan në punëtoritë e veçanta mbi zbatimin e Kodit të Procedurës Penale.

ANEX 1

Konkluzionet e Punëtorive në Prizren

1 tetor 2014 and 27 tetor 2014

Gjyqtarë Referues: Skender Çoçaj

A. Shqyrtimi fillestar dhe i dytë dhe mundësitë e shtuara të palëve për të mbledhur prova

1. Nuk ekziston një praktikë e vetme në mes të gjyqtarëve rreth shqyrtimit fillestar dhe atij të dytë (përkundër qarkores juridike të Gjykatës Supreme), gjegjësisht në rastet kur nuk paraqiten kundërshtime ndaj dëshmive të cekura në aktakuzë, ose ndonjë kërkesë për hedhjen e aktakuzës, disa gjyqtarë e caktojnë shqyrtimin e dytë ndërsa disa të tjerë e caktojnë shqyrtimin kryesor duke e tejkaluar shqyrtimin e dytë.

B. Roli i palës së dëmtuar

2. Kodi i Procedurës Penale përcakton që palët e dëmtuara duhet të jenë të pranishme gjatë shqyrtimit kryesor, mirëpo, ka raste kur ato nuk kanë interesim të marrin pjesë në procedurë dhe për këtë arsye shqyrtimet duhet shtyrë. 2) Mospërputhshmëritë në KPP në lidhje me praninë e palës së dëmtuar gjatë shqyrtimit fillestar: përderisa prania e të dëmtuarit gjatë shqyrtimit fillestar nuk është e paraparë (neni 245), në rast të pranimit të fajësisë në këtë shqyrtim mund të kërkohet edhe mendimi i palës së dëmtuar (neni 248(2)). 3) Shqyrtimet gjyqësore shtyhen në rastet kur pala e dëmtuar dukshëm nuk është e interesuar për të marrë pjesë në procedurë (për shembull rastet e KEDS-it), ndërsa disa nga dispozitat e KPP-së e bëjnë praninë e tyre të detyrueshme.

C. Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

3. Një numër i caktuar i rasteve përfundojnë me pranim të fajësisë, ndonëse, shumica prej tyre arrihen pas ngritjes së aktakuzës. 2) Është e vështirë të arrihet marrëveshje para ngritjes së aktakuzës pasi që prokuroria nuk mund të propozojë dënim më të ulët se minimumi i paraparë me ligj, ndërsa kur rasti i të pandehurit arrin në shqyrtim gjyqësor, gjykata e ka mundësinë – të cilën edhe e përdorë shpesh – që ta ulë dënimin nën minimumin e lejuar duke i zbatuar “rrethanat posaçërisht lehtësuese” (neni 75 i Kodit Penal).

Implementimi Kodit të të Procedurës Penale: Prizren

4. A është e mundur sipas Kodit të ri të zëvendësohet dënimi me burgim - i shqiptuar si rezultat i marrëveshjes për pranimin e fajësisë - me dënim me gjobë (neni 47 i Kodit Penal).

D. Marrja në pyetje e drejtpërdrejtë, e tërthortë dhe rimarrja në pyetje

5. Pjesëmarrësit u pajtuan që gjatë gjykimit këto teknika të reja të marrjes në pyetje shpeshherë nuk zbatohen në mënyrë të duhur.
6. Afati treditore për parashtrimin e propozimit për vazhdimin e paraburgimit nuk respektohet (neni 191 (2) i KPP-së).
7. Neni 164(5) i KPP-së: cili është statusi i personit të arrestuar pas 48 orëve? Neni 164(11) i KPP-së: duhet sqaruar. A do të thotë që kjo dispozitë nënkupton që një person mund të mbahet në arrest për 48 orë shtesë nga ana e gjykatës, apo që gjykata duhet të shpallë vendimin gojarisht menjëherë, ndërsa me shkrim brenda 48 orëve?

E. Paraburgimi

8. Gjyqtarët nuk e mbikëqyrin dhe nuk e ndërpresin paraburgimin sipas detyrës zyrtare, siç është e paraparë me nenin 192 të KPP-së;
9. Propozimet për paraburgim jo shpesh arsyetohen sa duhet.

F. Drejtësia për të Mitur

10. Disa dispozita të KPP-së janë në kundërshtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Për shembull, neni 53(5) i KPP-së parasheh që personat nën moshën 18 vjet mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës, ndërsa Kodi për të Mitur kërkon detyrimisht mbrojtës.

G. Rekomandimet nga punëtoritë:

- Nenet e veçanta të KPP-së të cekura më lartë duhet të rishikohen, e sidomos ato në lidhje me: 1) rolin e palës së dëmtuar në procedurë penale; 2) ato mbi domosdoshmërinë e shqyrtimit të dytë në të gjitha rastet penale.
- Politikat e ndëshkimit të gjykatave duhet analizuar me qëllim të përcaktimit të mungesave që mund të ndikojnë në negocimin e marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë;
- Negocimi i marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë: avokatët dhe prokurorët duhet të punojnë më tepër rreth këtij instituti të ri, në benefitin e tyre të dyanshëm. Të gjitha

Implementimi Kodit të të Procedurës Penale: Prizren

rastet, ku e lejon ligji, duhet fillimisht të nisin duke i propozuar marrëveshje të pandehurve.

- Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët duhet të aftësohen edhe më tej mbi teknikat e marrjes në pyetje e në veçanti të atyre mbi marrjen e tërthortë në pyetje.
- KPP duhet të harmonizohet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.
- Gjyqtarët dhe prokurorët duhet t'i respektojnë afatet kohore kur kërkohet/urdhërohet paraburgimi.

ANEX 2

Konkluzionet e Punëtorive në Gjakovë/Djakovica

7 tetor 2014 and 5 tetor 2014

Gjyqtarë Referues: Nikollë Komani

A. Mundësi më të mëdha të palëve për të mbledhur

1. Në praktikë është e vështirë të sigurohet barazia e armëve. Disa nga dispozitat e KPP-së – në veçanti ato në lidhje me fazën e hetimeve – e kufizojnë rolin e mbrojtjes. Mirëpo edhe praktika nuk qëndron në përputhshmëri me KPP-në: prokurorët shpeshherë nuk arrijnë t'u sigurojnë mbrojtësve qasje të pakufizuar në shkresat e lëndës (neni 213 i KPP-së).
2. Roli i gjyqtarit të procedurës paraprake është vendimtar në kuadër të Kodit të ri;
3. Pozita jo e favorshme e mbrojtjes vërehet në rastin e ekspertizës: derisa prokuroria e posedon dokumentin origjinal, për mbrojtjen është e pamundur të ofrojë ekspertizë të veten ngase mbrojtja nuk ka mundësi t'ia dërgojë ekspertit dokumentin origjinal për të realizuar ekspertizën;
4. Disa nga pjesëmarrësit u pajtuan që shqyrtimi fillestar dhe i dytë ndonjëherë janë vetëm humbje kohe ngase të gjitha aktivitetet procedurale mund të përqëndrohen dhe ndërmerren në kuadër të një shqyrtimi të vetëm përgatitor, - në veçanti kur janë në pyetje veprat e lehta penale.

B. Paraburgimi

5. Shumica e pjesëmarrësve konstatuan që ka raste kur kërkesat e prokurorit për caktim ose vazhdim të paraburgimit nuk paraqiten në kohë ose nuk janë të arsyetuara mirë. Duhet të ketë mbikëqyrje më efikase të masës së paraburgimit nga ana e gjykatave. KGJK përfundon duke paguar shuma të mëdha si kompensim për paraburgim të paligjshëm: deri më tani, për vitin 2014 më shumë se 400 mijë euro janë paguar në këtë drejtim.
6. Afati treditor i përcaktuar në nenin 191(2) të KPP-së brenda të cilit prokurori duhet ta njoftojë të akuzuarin dhe mbrojtjen me propozimin për vazhdimin e paraburgimit

shpeshherë nuk respektohet. Në këto raste a duhet gjyqtari ta refuzojë një propozim të tillë si të vonuar? Kur vazhdoet paraburgimi sipas nenit 191, prokurori ta informojë paraprakisht në kohë mbrojtësin dhe të pandehurin.

C. Roli i palës së dëmtuar

7. Braktisja e mundësisë së palës së dëmtuar për të ndërmarrë ndjekje subsidiare në rastet kur prokurori tërhiqet nga ndjekja penale ka krijuar pakënaqësi tek palët e dëmtuara. Praktika tregon që mënjanimi i ndjekjes subsidiare ka qenë i parakohshëm. Nuk ka qenë veçël efikase, mirëpo ka qëndruar si garanci për palën e dëmtuar. Pala e dëmtuar duhet së paku të ketë të drejtën të bëj ankesë kundër të gjitha bazave.
8. Koordinatorin për dëshmëpërblimin e viktimave nuk është caktuar ende, ndonëse kjo parashihet në nenin 62 të KPP-së.

D. Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

9. Në rajonin e Gjykatës Themelore të Gjakovës nuk aplikohet. Arsyeimi qëndron në mungesën e kohës së prokurorëve, si dhe disa thonë se mbrojtja nuk është edhe aq aktive në këtë drejtim.
10. Gjykimet nuk incizohen me mjete audio/video, në kuptim të nenit 315 të KPP-së.
11. Zbatimi i urdhrave për anonimitet nga publiku (neni 223 i KPP-së) dhe nga i pandehuri (neni 224 i KPP-së) shpeshherë nuk realizohen. Ka vështirësi në zbatimin e tyre – ka pasur raste kur identiteti është zbuluar përkundër ekzistimit të këtyre masave.

E. Marrja në pyetje

12. Në praktikë hasen probleme nga moszbatimi i mirë i këtyre teknikave.
13. Departamenti për krime të rënda është i ngarkuar me vepra penale të cilat mund të kalojnë në departamentin e përgjithshëm (neni 22 i KPP).

F. Rekomandimet nga punëtoritë:

- Nenet e KPP-së të veçuara më lartë duhet të rishikohen që të mos bien ndesh me njëri tjetrin;
- Të dyja palët, si prokuroria ashtu edhe mbrojtja duhet të marrin një rol më proaktiv gjatë propozimit të dëshmive në fazat më të hershme të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa gjyqtari i procedurës paraprake duhet të ruajë rolin e tij/saj dominues në përgatitjen e rastit dhe të bëjë vlerësimin e propozimeve të palëve me kujdes;
- Para se të propozohet paraburgimi, të shqyrtohen nëse është e mjaftueshme të shqiptohet ndonjë nga masat alternative. Prokurorët duhet t'i paraqesin propozimet për caktim të paraburgimit me kohë si dhe t'i arsyetojnë ato. Gjykatat duhet t'i hedhin poshtë propozimet e paafatshme ndërsa t'i refuzojnë propozimet jo të arsyetuara mirë. Është përgjegjësia përfundimtare e gjyqtarit për të siguruar që arsyet e paraburgimit janë të mjaftueshme dhe të shtjelluara deri në imtësi.
- Të gjitha shqyrtimet gjyqësore duhet të incizohen përmes mjeteve audio dhe video në mënyrë që të jenë në pajtim të plotë me KPP-në.
- Nevojiten më shumë trajnime për përsosjen e teknikave të marrjes në pyetje (të drejpërdrejtë, të tërthortë dhe rimarrjes në pyetje).
- Neni 22 i KPP të rishikohet, në kuptim të kalimit të disa veprave penale nga departamenti për krime të rënda në departament të përgjithshëm.

ANEX 3

Konkluzionet e Punëtorive në Pejë/Peç

2 tetor 2014 and 3 tetor 2014

Gjyqtarë Referues: Nushe Kuka-Mekaj

A. Mundësitë e shtuara të palëve për të mbledhur prova

1. Edhe pse Kodi i ri u siguron palëve në procedurë më shumë mundësi për prezantimin e provave të tyre, kjo zbatohet me vështirësi në praktikë. Janë gjykatat përsëri ato që përfundojnë në mbledhjen e provave pasi që palët nuk e bëjnë atë;
2. Neni 141 mbi të drejtat e pandehurit për angazhimin e ekspertit është e hartuar dobët, e paqartë dhe i mungojnë detajet;
3. Caktimi i seancës së dytë në rastet kur nuk ka prova të prezantuara nga mbrojtja, duket si e tepërt, sidomos në rastet që gjykohen në Departamentin e përgjithshëm, si: vjedhja e rrymës;
4. Prokuroria shpesh dorëzon provat dhe akatakurën vetëm gjatë seancës fillestare.

B. Roli i palës së dëmtuar

5. Avokatët pothuajse njëzëri erdhën në përfundim se braktisja e mundësisë së prokurorit subsidiar në rastet kur prokuroria heq dorë nga ndjekja paraqet pengesë serioze për palën e dëmtuar. Pjesëmarrësit tjerë, sidomos gjyqtarët, nuk u pajtuan me këtë, duke deklaruar se prokurori subsidiar nuk ka qenë mjet i suksesshëm dhe ka paraqitur ngarkesë për gjykatën. Kodi zvogëlon të drejtat e palës së dëmtuar (p.sh; ankesa në lidhje me kualifikimin e veprës, nuk lejon angazhimin e tre avokatëve siç është e lejuar me të pandehurit).

C. Marrëveshjet për pranimin e fajësisë

6. Në fillim, prokuroria bënte marrëveshje për pranimin e fajësisë, por jo më. Së fundi, palët shmangin marrëveshjet e pranimit të fajësisë para gjykimit për shkak se prokuroria nuk mund të propozojë dënim më të ulët se minimumin e dënimit të paraparë me ligj, ndërsa kur i pandehuri gjykohet, gjykata ka mundësi – dhe vepron ashtu në të shumtën e rasteve – cakton dënim më të ulët se sa minimumin duke e arsyetuar atë me “rrethana posaçërisht lehtësuese.” Logjikisht, të pandehurit janë të dekurajuar për marrëveshjet e

pranimi të fajsisë me prokurorë kur sipas praktikës gjykata i dënon ata/ato me dënim më të ulët.

D. Marrja e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë në pyetje

7. Është e evidente se që të gjithë - gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët nuk e kanë kuptuar esencën e teknikave të reja të marrjes në pyetje, e sidomos të marrjes së tërthortë në pyetje.

E. Seancë fillestare

8. Prania e palës së dëmtuar nuk është e obliguar në seancë fillestare në bazë të nenit 245(1). Por në qoftë se pranimi i fajësisë është deklaruar në këtë seancë, atëherë pikëpamjet e palës së dëmtuar duhet të merren parasysh;.
9. Neni 245(1) parasheh praninë e mbrojtjes, pa përjashtim. Por çfarë ndodh në rastet kur mbrojtja nuk është e detyrueshme?
10. Neni 245(1) kundrejt nenit 248(4) KPP –a duhet të ftohet pala e dëmtuar?

F. Shërbimi në Komunitet

11. Neni 48 dhe 60 të Kodit Penal janë në kundërshtim me njëri tjetrin (gjashtë muaj apo 1 vit?);

G. Masa e paraburgimit

12. Arsytimi i dobët i prokurorit mbi kërkesën e masës së paraburgimit zakonisht bëhet për shkak të kohës së pamjaftueshme, megjithatë, ata do vazhdojnë të veprojnë njëjtë përderisa gjykata vazhdon të caktojë masën e paraburgimit në bazë të atyre kërkesave të paarsyetuara mirë.
13. Shumë kontradikta në mes të KPP-së dhe Kodit për të mitur. Ato duhet të harmonizohen, urgjent për rastet e paraburgimit.
14. Përbërja e trupit gjykues – anëtarët e trupit gjykues të cilët nuk janë nga departamenti i krimeve të rënda siç parashihet në KPP.

H. Rekomandimet nga punëtoritë:

- Nenet e veçanta të KPP-së të përmendura më lart duhet korrigjohen me qëllim që të shmangen kontradiktat;

Implementimi i Kodit të të Procedurës Penale: Pejë/Peç

- Edhe prokuroria edhe mbrojtja duhet të marrin rol më aktiv në propozimin e provave në fazat më të hershme të gjyqimit;
- Gjykatat duhet të shqyrtojnë politikat ndëshkimore në mënyrë të përcaktimit të mungesave që ndikojnë në negociimin e pranimin të fajësisë;
- Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët duhet të trajnohen në vazhdimësi për teknikat e marrjes në pyetje, sidomos në marrjen e tërthortë në pyetje.

ANEX 4

Konkluzionet e Punëtorive në Mitrovicë/Mitrovica

30 Shtator and 21 Shtator 2014

Gjyqtarë Referues: Ali Kutllovci

A. Vështirësitë në trajtimin e rasteve që përfshijnë personat me çrregullime mendore.

1. Ndonëse Kodi i Procedurës Penale prekë disa aspekte procedurale të procedurave që përfshijnë persona të tillë, ai ende nuk i përgjigjet plotësisht shumë situatave faktike që mund të përfshijnë persona me çrregullime mendore. Së dyti, ndërkohë që Kodi njeh mundësinë e ndryshimit të masës së shqiptuar të këtyre personave, ai ende nuk i përcakton kushtet, procedurat ose rrethanat në të cilat kjo mund të ndodhë.

B. Çështja e pranimit të fajësisë

2. Është problematike kur aktakuza përmban më shumë pika të akuzës, dhe i pandehuri nuk ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat, por vetëm një ose disa prej tyre. (neni 248 i Kodit). Praktika gjyqësore në situata të tilla nuk është e unifikuar për shkak të mungesës së udhëzimit. Ngjashëm me këtë problem është çështja e rasteve që përfshijnë dy ose më shumë të pandehur. Nëse një nga të pandehurit pranon fajin dhe tjetëri jo, a duhet gjykata të lëshojë menjëherë një aktgjykim për atë që u deklarua fajtor apo të pres derisa rasti është përfunduar me të pandehurin tjetër dhe të nxjerrë një aktgjykim për të dy. Ekziston rreziku se i pandehuri i cili u deklarua fajtor (ka pranuar fajësinë) mund të revokojë atë në çdo fazë gjatë vazhdimin të gjyqimit kryesor kundër të pandehurit tjetër.

C. Drejtësia për të Mitur

3. Ka një kundërshtim të dukshëm në mes të Kodit për të Mitur dhe Kodit të Procedurës Penale Veçanërisht në rastet që përfshijnë të pandehur madhorë të rinj (të pandehur mes 18-21 vjeç). Kodi i Procedurës Penale tregon " [...] vlerësimin e pjekurisë të madhorit të ri [...]" pa përcaktuar se si do të bëhet vlerësimi dhe nga kush.

D. Aktakuza

4. A ka të drejtë prokurori të ngre aktakuzë për veprat penale ndjekja e të cilave varet nga propozimi i të dëmtuarit apo leja paraprake e organit kompetent, pra kur me rastin e paraqitjes së rastit penal tek organet e ndjekjes i dëmtuari nuk është pyetur për pëlqimin e tij për ndjekje penale? Në raste të tilla, a mund të konsiderohet raportimi i rastit penal nga

i dëmtuari tek organet e ndjekjes si propozim për ndjekje penale apo propozimi për ndjekje duhet të bëhet pas raportimit të rastit tek organet e ndjekjes në mënyrë të shprehur dhe të shkruar, dhe atë më së largu brenda 48 orëve.

5. Prokurorët nuk janë të kënaqur me mendimin juridik të Gjykatës Supreme se gjykatat nuk duhet të pranojë asnjë akuzë të drejtpërdrejtë të paraqitur nga prokuroria për veprat penale të dënueshme me më shumë se (3) tri vjet dënim me burg, edhe pse e respektojnë atë. Mendimi i tillë nuk është në pajtim me KPP.
6. Çka të bëhet në rastet kur pas ngritjes së aktakuzës paraqitet nevoja për sekuestrimin/ngrirjen e aseteve? KPP ka rregulluar situatën para ngritjes së aktakuzës dhe ka paraparë kompetencat e gjyqtarit të procedurës paraprake, mirëpo këto kompetenca nuk i ka edhe kryetari i trupit gjykues!
7. **Ndërmjetësim**
8. Opinioni juridik i Gjykatës Supreme parasheh se gjyqtarët mund të dërgojnë rastet për ndërmjetësim në mënyrë të pavarur nga prokuroria, por nuk jep ndonjë udhëzim se cila është procedura për ta bërë këtë.

E. Konfiskimi

9. Në lidhje me pasurinë që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, KPP parasheh në nenin 282 (4) se policia njofton prokurorin shtetit për veprime të ndërmarra sipas paragrafit 3 të këtij neni, por nuk shpjegon se kush jep urdhra për ndërmarrjen e këtyre veprimeve.

F. Krijimi i të dhënave mbi dënimet e mëparshme të të pandehurve.

10. Një gjyqtar konsideron se gjykata duhet të mbajë të dhëna vetëm për dënimet e jo për procedurat penale në përgjithësi.

G. Marrja në pyetje

11. Shqetësim i veçantë është mungesa e njohurive mbi marrjen në pyetje në mënyrë të tërthortë dhe mbi teknikat e marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje nga të gjitha palët e përfshira.

G. Rekomandimet e tryezës:

- Të ketë një tryezë të rrumbullakët të ngjashme për Kodin Penal të Kosovës Të ketë një diskutim në tryezë të rrumbullakët në mes të gjykatësve të Gjykatës Themelore në

Implementimi i Kodit të të Procedurës Penale: Mitrovicë/Mitrovica

Mitrovicë dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit duke përfshirë edhe kryetarin e Gjykatës së Apelit.

- Gjykata Supreme të nxjerrë një qëndrim parimor se cili departament i gjykatës do të merret me rastet që përfshijnë madhorët e rinj dhe të mos e lënë atë në diskrecionin e gjyqtarit që të vendosë në raste individuale.
- Gjykata Supreme të jep mendim juridik/udhëzim për procedurën e ndërmjetësimit.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të sigurojë që gjykatat të kenë një bazë të dhënash të personave për të pasur informim sa më të drejtë mbi dënimet e mëparshme.
- Duhet të ketë trajnim intensiv dhe të qëndrueshëm për gjykatës, prokurorë dhe avokatë mbi teknikat e pyetjeve të tërthorta, pyetjeve të drejtpërdrejta, te ri-marrjes në pyetje.
- Te amandamentohet KPP në pjesën që ka të bëjë me sekuestrimin/ngritjen e aseteve në periudhën pas ngritjes së aktakuzës e deri në përfundim të shqyrtimit kryesor .
- Te ri-shqyrtohet çështja e pagave për gjyqtarë që është nën nivelin e duhur.
- Te krijohet një data bazë e menaxhuar nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor në të cilën do të regjistroheshin në mënyrë elektronike të gjitha lëndët gjyqësore. Në këtë data bazë të kenë qasje të gjitha gjykatat, me leje të Sekretariatit.
- Gjykata Supreme t'i rishikoj qëndrimet e saja parimore sa i përket veprave penale "Tregti e ndaluar" dhe "Kontrabandim i mallrave". Sipas njërit qëndrim parimor të GJS, vepra penale "Tregti e ndaluar" konsumohet kur vlera e mallrave është mbi 5.000 euro, ndërsa sipas qëndrimit tjetër parimor, vepra penale "Kontrabandim i mallrave" konsumohet kur shmangia e detyrimeve doganore është mbi 5.000 euro. Në një situatë të këtillë, ka aktakuza kur për të njëjtat mallra akuzohen dy persona, njëri për "Tregti të ndaluar" ndërsa tjetri për "Kontrabandim me mallra".
- Pjesëmarrësit e zgjedhën gjyqtarin Ali Kutllovci si gjyqtar raportues për rajonin e Mitrovicës.

ANEX 5

Konkluzionet e Punëtorive në Prishtinë/Priština

29 Shtator 2014 and 20 Shtator 2014

Gjyqtarë Referues: Hava Haliti

A. Policia gjyqësore nuk është paraparë në Kodin e ri të Procedurës Penale.

1. Është e vështirë për prokurorinë, veçanërisht në rastet e figurave politike për të marrë mbështetjen e plotë të policisë në zbatimin e urdhrave, duke pasur parasysh varësinë e policisë nga pushteti ekzekutiv. Kjo ndikon në pavarësinë e gjyqësorit.

B. Shqyrtimin kryesor dhe dhe të dytë

2. Prezumimi i pafajësisë është i rrezikuar nga angazhimi i të njëjtit gjyqtar edhe për seancën fillestare dhe të dytë, si dhe për shqyrtimin kryesor. Gjyqtari formon një bindje paraprake në lidhje me çështjen, sidomos kur gjyqtari, duke vendosur mbi kërkesën e mbrojtjes për hedhjen e aktakuzës, shqyrton lëndën dhe analizon provat e propozuara.

C. Intervista dhe dëshmia ne proceduren paraghyqësore

3. KPP i jep fuqi të ndryshme provuese marrjes në pyetje në procedure paraprake dhe deklaratës në procedure paraprake (neni 123 (2) dhe (3) i KPP).

4. Roli i mbrojtësve

5. Roli i mbrojtësve tjerë që nuk janë “mbrojtësi kryesor” është i kufizuar kur i pandehuri angazhon më shumë se një mbrojtës, sepse vetëm “mbrojtësi kryesor” ka të drejtë të përfaqësojë palën gjatë procedurës (KPP neni 19 (1.28)).

D. Parashtrimi i provave

6. Prokuroria ndonjëherë nuk arrin që t’i ofrojë provat me kohë mbrojtjes.

E. Marrja e drejtpërdrejtë, e tërthortë dhe rimarrja në pyetje.

7. Gjykata ende ka rol aktiv. Të gjithë pjesëmarrësve në procedurë u mungon përvoja në marrjen e tërthortë në pyetje. Ende më shqetësuese është gjendja me të akuzuarit pa mbrojtës në rastet kur mbrojtja nuk është e detyruar. Në këto raste, gjykata është në dilemë: t’i caktojë të akuzuarit mbrojtës sipas detyrës zyrtare mbi bazën e „interesave të drejtësisë“, apo ta lërë të akuzuarin të mbrohet vetë, duke ia rrezikuar atij potencialisht të drejtën për gjykim të drejtë.

F. Pala e dëmtuar

8. Dispozitat e KPP-së për rolin dhe pjesëmarrjen e palës së dëmtuar gjatë gjithë rrjedhës së procedurës nuk janë të përcaktuara mirë dhe nuk janë mjaft të qarta. A duhet i dëmtuari të jetë i pranishëm në seancën fillestare? Gjykata e Apelit e fton detyrimisht, po kjo shkakton probleme posaçërisht nëse i dëmtuari nuk ka marrë pjesë në procedurën e shkallës së parë.

G. Kohëzgjatja e hetimit

9. Neni 158 (3) parasheh që hetimi do të përfundojë automatikisht pas kalimit të afatit nga neni 159 i këtij Kodi. Praktika tregon se prokurorët shpesh zgjasin hetimet - deri në 2 vite egjysmë pa ngritje të aktakuzës.

H. Aktakuza

10. Shqetësime lidhur me aktakuzat e ngritura pa rekomandim për provat që duhet prezantuar (si që kërkohet nga neni 241 (1.6) i Kodit), posaçërisht nga prokuroria speciale.

I. Diskutim mbi tema specifike të KPP

- Neni 94 (2, 3) flet për "zgjatjen" dhe "ripërtëritjen" e urdhrave. Ndoshta këto terma duhet të definohen në nenin 19 të KPP;
- Neni 125 (4) duket të jetë në kundërshtim me të drejtën e mbrojtjes së detyruar, ai duhet ose të harmonizohet me të ose të shtohet fjala "mund": "Mbrojtësi juaj mund të jetë i pranishëm";
- Afati i dhënë në nenin 132 (6) është shumë i shkurtër..
- Ka një perceptim të përgjithshëm se ka mangësi jo vetëm me zbatimin e Kodit, por edhe mospërputhje të shumë dispozitave të të njëjtit, gjë që kërkon një qasje më gjithëpërfshirëse për amendamentimin e tij.
- Një komentari i Kodit do të kontribuonte në masë të madhe në zbatimin e drejtë të Kodit.

Rekomandimet nga punëtoritë:

- Propozohet amendamentimi i dispozitave të veçanta të KPP-së si më lartë.
- Të krijohet policia gjyqësore dhe të jetë nën juridiksionin e prokurorit të shtetit nën hierarkinë e drejtpërdrejtë të prokurorisë;

Implementimi i Kodit të të Procedurës Penale: Prishtinë/Priština

- Ekziston nevoja për një kod të ri dhe të përditësuar të etikës për gjyqtarë dhe prokurorë.
- Neni 158 duhet të ndryshohet në mënyrë që të caktojë detyrim për prokurorin që ose të ngre aktakuzën ose të heq dorë nga hetimi.
- Propozohet që të reduktohet caktimi i shpeshtë i masës së paraburgimit.
- Gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve u nevojiten më shumë trajnime për përmirësimin e shkathtësive të tyre praktike për zbatimin e marrjes së drejtpërdrejtë, të tërthortë dhe rimarrjen në pyetje.
- Propozohet krijimi i një grupi punues profesional i përbërë nga gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë, i cili do t'i identifikojë të gjitha mangësitë e Kodit dhe do të propozojë amendamente përkatëse.

ANEX 6

Konkluzionet e Punëtorive në Ferizaj/Uroševac

8 tetor and 6 Nëntor 2014

Gjyqtarë Referues: Arben Hoti

1. Rishikimi i nenit 22 për sa i përket **veprave penale të ndara në departamente**. Disa vepra penale si për shembull armëmbajtja pa leje duhet të kaloj nga Departamenti për krime të rënda në Departamentin e përgjithshëm. Përderisa vepra penale shmagne nga tatimi për vlera të larta duhet të kalojnë nga Departamenti i përgjithshëm në Departamentin për krime të rënda.
2. Harmonizimi i Kodit të Procedurës Penale me Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Qështja e rasteve kur madhorët e rinj janë të involvuar, dispozitat e cilit kod duhet të zbatohen.
3. Të sigurohen komentar për institutet e përfshira në Kodin e Procedurës Penale, p.sh. Marrja në pyetje në mënyrë të tërthortë

Marrja në pyetje.

4. Kryetari i trupit gjykues/Gjykatësi i vetëm duhet të lejoj hapësirë për avokatët në rastet e marrjes në pyetje, si dhe të inkurajoj debatin dhe diskutimin dinamik.
5. Trajnim për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët mbrojtës për teknikat e marrjes në pyetje.
6. Presenca e palës së dëmtuar në procedurë duhet të jetë që nga seanca fillestare.
7. Të pajisen gjykatat, prokuroritë dhe stacionet policore me **mjete për audio dhe video inçizim**.
8. Shfrytëzimi i mjeteve juridike. Palës së dëmtuar duhet t'i jepet e drejta ta kundërshtoj aktgjykimin e nxjerr sipas kërkesës për urdhër ndëshkimor në rastet kur ka vepër penale të kryer kundër trupit të palës së dëmtuar, si p.sh. lëndimi i lehtë trupor.
9. Neni 381 i KPP i jep të drejtë të gjitha palëve në ankesë përfshirë edhe palën e dëmtuar, ndërsa neni 496 i jep të drejtën e kundërshtimit të aktgjykimin me urdhër ndëshkimor vetëm të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës.

ANEX 7

Konkluzionet e Punëtorive në Gjilan/Gnjilane Workshops

8 tetor and 4 Nëntor 2014

Gjyqtarë Referues: Agim Ademi

A. Roli i palës së dëmtuar

1. Nuk ka ndonjë qëndrim të përbashkët ndër gjyqtarë për sa i përket rolit të palës së dëmtuar në procedurën penale. Në veçanti, çështja e përfaqësimit mbetet brengë. Disa nga gjyqtarët nuk janë të sigurt nëse përfaqësimi i palës së dëmtuar në procedurën penale është i domosdoshëm, dhe nëse po, kush duhet të jetë përfaqësuesi sipas nenit 63 paragrafi 1, 2 dhe 3 i KPP. Pala e dëmtuar mund të përfaqësohet në tri mënyra: nga një anëtarë i Odës së Avokatëve të Kosovës, nga mbrojtësi i viktimave, dhe të përfaqësoj vetveten. Fjala e përdorur në nenin 63 paragrafi 1 “mundet” lë dyshim tek gjyqtarët kur vjen në pyetje çështja e përfaqësimit të palës së dëmtuar. E njëjta vlen edhe për alternativën e dhënë në paragrafin 1, 2 dhe 3 të po të njëjtit nen.

B. Negociatat për pranim të fajësisë

2. Pranimi i fajësisë mbetet institut kyç në procedurën penale si dhe kjo mund të konsiderohet si një nga përmirësimet më të mëdha që ka sjellë ky Kod i ri i Procedurës Penale. Sidoqoftë, prokurorët ende nuk e shfrytëzojnë autoritetin që iu është dhënë nga KPP për të iniciuar pranimin e fajësisë dhe kjo është një gjë që duhet të përmirësohet. Për sa i përket dënimeve kur rastet kryhen me pranim të fajësisë, mendimi i palës së dëmtuar nuk është i nevojshëm. Nëse të pandehurit nuk e pranojnë fajësinë për të gjitha akuzat në aktakuzë, atëherë nuk ka hapësirë të shkohet më tutje me pranim të fajësisë. Rajoni i Gjilanit prinë me numrin e rasteve të zgjidhura me pranim të fajësisë. Që prej kohës kur Kodi i ri i Procedurës ka hyrë në fuqi, 200 raste me pranim të fajësisë kanë arritur të zgjidhen; në anën tjetër, prokuroria ka pranuar 300 kërkesa nga avokatët mbrojtës për iniciimin e negociatave për pranimin e fajësisë çdo prokuror nga prokuroria themelore në Gjilan do të urdhërohet të inicioj marrëveshje për pranimin e fajësisë për çdo rast. Këtu është menduar vetëm në ato raste ku rrethanat (e rastit) e lejojnë një gjë të tillë. Bashkëpunimi ndërmjet prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës vazhdon të mbetet mjaft mbresëlënëse.

C. Paraburgimi

3. Afatet e parapara në KPP për sa i përket ankesave kundër vendimeve për paraburgim nuk respektohen gati se asnjëherë. Përmirësimi i kësaj gjendje është nevojë urgjente; në veçanti Gjykata e Apelit duhet të jetë më efektive ngase vonesat zakonisht shkaktohen nga kjo gjykatë. Ka raste kur gjykata e apelit e ka kaluar afatin 48 orësh deri në 22 ditë derisa ka vendosur për ankesat e ushtruara kundër masës së paraburgimit, dhe kjo është një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Arsyetimi i vendimeve për masën e paraburgimit edhe më tutje mbetet një brengë; gjyqtari paraprak nuk ofron arsye të mjaftueshme përderisa vendos për dhënien e paraburgimit si masë, e njëjta vlen edhe për prokurorët kur dorëzojnë kërkesat dhënien e paraburgimit. Praktike e tashme e procedurës për vazhdimin e masës së paraburgimit duhet të përmirësohet, gjithashtu. Dhe në fund, kufizimet kohore për sa i përket ankesave kundër vendimit për paraburgim duhet të respektohen, si dhe vendimet për paraburgim duhet jenë mirë të arsyetuara duke përfshirë këtu kërkesën e prokurorit për paraburgimin. Këto të meta e shkelin të drejtën kushtetuese, nëse i referohemi nenit 29 të Kushtetutës së Kosovës..

D. Caktimi i seancës së dytë

4. Ekzistojnë praktika të ndryshme ndërmjet gjyqtarëve për sa i përket mbajtjes së seancës së dytë. Dilemat dalin kur palët nuk parashtrajnë mocione për refuzimin e aktakuzës. Sipas kësaj disa gjyqtarë mbajnë seancën e dytë pa i ftuar palët për të marrë pjesë, dhe mbajnë procesverbal për seanca të tilla, përderisa disa gjyqtarë tjerë nuk veprojnë në këtë mënyrë.

E. Vonesat e shkaktuara për shkak të ekspertëve

5. Ka qenë një praktikë e zakonshme që ekspertët që dorëzojnë raportet e tyre të mos gjobiten fare apo rrallë për vonesat e tyre. Kjo praktikë duhet të përmirësohet, dhe gjyqtarët duhet të fillojnë të aplikojnë dispozitat ligjore të KPP të cilat iu japin autoritet atyre për vendosjen e gjobave të tilla. Efekti i menjëhershëm do të ishte shmangia e vonesave dhe rritja potenciale e buxhetit të gjyqësorit.

F. Referimi i rasteve penale në ndërmjetësim

6. Pa marrë parasysh faktin që ligji e lejon këtë, Gjykata Themelore në Gjilan nuk ka filluar ende të referoj rastet penale në ndërmjetësim. Nëse kësi lloj praktike do të filloj të praktikohet, numri i lëndëve të pazgjidhura do të zvogëlohej.

G. Procedura për dhënien e urdhrin ndëshkimor

7. Si të vepohet në rast se i pandehuri ka paraqitur kundërshtim kundër urdhrin ndëshkimor dhe në të njëjtën kohë pas caktimit të shqyrtimit ai nuk paraqitet në seancë.

8. Siguria e gjyqtarëve dhe e prokurorëve si dhe kushtet e tyre të punës

Ishte një qëndrim i përbashkët se të dy palët, KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të bëjnë me tepër sa i përket ofrimit të sigurisë për gjyqtar dhe prokuror. Në veçanti janë ngritur shqetësime rreth mungesës së kushteve në lidhje me transportin, masat e sigurisë brenda dhe jashtë objekteve të gjykatave dhe prokurorive si dhe ngritja e pagave

H. Rekomandimet e nxjerra nga tryeza

- Përfaqësimi i palës së dëmtuar duhet të qartësohet. Neni 63 paragrafi 1, 2 dhe 3 nuk sigurojnë udhëzim preciz se si të vepohet;
- Çdo prokuror duhet të inicioj marrëveshjen për pranimit të fajësisë në çdo rast (në qoftë se rrethanat e rastit e lejojnë një gjë të tillë);
- Afati për sa i përket ankesave ndaj paraburgimit duhet të respektohet, dhe vendimi mbi paraburgimin duhet të arsyetohet mirë, sikurse duhet edhe kërkesa e prokurorit për paraburgim;
- Një praktikë unike duhet të praktikohet për sa i përket seancës së dytë;
- Gjyqtarët duhet të fillojnë me zbatimin e dispozitave të KPP të cilat i japin autoritet të vendosin për gjopa ndaj ekspertëve që dorëzojnë raportet me vonesë;
- Praktika e referimit të rasteve penale në ndërmjetësim duhet të filloj pa vonesa. Trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët vendor për rolin e ndërmjetësimin në procedurën penale konsiderohet si nevojë thelbësore.
- Pjesëmarrësit zgjedhën gjykatësin Agim Ademaj si gjykatës referues për regjionin e Gjilanit